



Lenda: Kërkesë për Informim Online
Për: znj. Anila DENAJ – Ministër i Financave
Znj. Alma BEJA- Drejtore Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit
CC: Media
Nga: AIS / Open Data Albania

E nderuar zonja Ministre,

E nderuar zonja Drejtore e Thesarit të Shtetit,

AIS, organizatë jo qeveritare, promotore e Open Data Albania, duke shprehur konsideratë për institucionin dhe punën tuaj, dhe duke vlerësuar nevojën për transparencë dhe integritet në menaxhimin e fondeve të dhuruara dhe besuara Qeverisë Shqiptare për menaxhimin e situatës së fatkeqësisë natyrore të krijuar pas Tërmetit të datës 26 nëntor, parashtron kërkesën si vijon:

- Publikim në kohë reale ose në mënyrë periodike çdo ditë (çdo 24 orë) të Listës së donatorëve dhuruesve në Thesarin e Shtetit si ndihmë për dëmin e shkaktuar nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019. Lista duhet të ketë qartë të identifikuar donatorët dhe shumat e dhuruara nga qeveri, individ, subjekte ekonomike dhe entitete të tjera.

Ju mund të vendosni një material *excel* apo *word* çdo ditë në web faqen e institucionit tuaj, sikurse mund të na i përcillni me email në adresën tonë info@ais.al . Ne do të përpiqemi të ndajmë gjerësisht me publikun informacion dhe falënderime, duke e konsideruar këtë lloj transparence një përpjekje për mirëbesim dhe mirëqeverisje.

Kjo transparence kërkohet në bazë të Ligjit për të Drejtën e Informimit dhe Parimit të Mirëqeverisjes përmes Transparencës.

Gjithashtu organizata jonë është në dispozicion për të publikuar, shpërndarë dhe promovuar në web faqet dhe rrjetet tona sociale, të materialeve informative dhe jo vetëm, që Ministria e Financave dhe Qeveria Shqiptare do të përgatisin më qëllim ngritje fondesh për situatën e krijuar.

Me respekt

Aranita BRAHAJ
Drejtore Ekzekutive
Instituti Shqiptar i Shkencave (AIS)

Adresë postare:
Rr "Asim Vokshi"
Pallati 13/25 Kati 3
Tiranë.
Tel 0682001718
Email: aranita.brahaj@ais.al

Aranita Brahaj

